



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:151468

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760050

C.nr.1261/2020

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Genc Hasani, në kontestin e paditësve Sh. H. nga M. R. U. nga V. Sh. H. nga M. dhe B.U. nga V., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit me shkrim av. Nexhat Beqiri, nga V., kundër të paditurës KEDS Sh.A, - Dega Mitrovicë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Vlora Krasniqi, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 1960.61 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **30.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tersi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve: Sh. H. nga M. R. U. nga V. Sh. H. nga M. dhe B.U. nga V. **DETYROHET** e paditura KEDS Sh.A, - Dega Mitrovicë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në vitin 2015 në paluajtshmerite-pronat kadastrale me numër P-71208024-01016-0, Komuna e Mitrovicës, zona kadastrale V. lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private, vendi i quajtur Sh.i i A., ne sipërfaqe prej 0.66.58ha dhe ne parcelën P-71208024-01017-0, Komuna Mitrovicë, zona kadastrale V., lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private vendi i quajtur Sh.i A., ne sipërfaqe 5.03.82ha, për prerjen e pyllit të ja kompensojë shumën prej 1960.61 euro, dhe atë me kamate ligjore prej 8% duke paguar prej momentit të paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat 15 ditore nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të ia paguajë paditësve në shumë të përgjithshme prej 932.00 €, të gjitha këto në afat 7 ditore nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate fillimisht ka paraqitur padi, paditësi H. U. me dt. 22.09.2015, kundër të paditurës KEDS Sh.A, me dt. 28.12.2016, kjo gjykate ka marrë aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë pjesërisht të bazuar. E paditura ka paraqitur ankese, e cila është aprovuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë dhe çështja është kthyer në procedim të serishëm me vërejtjet e theksuara si në aktgjykim. Në seancën e caktuar nga gjykata janë paraqitur trashëgimtarët e paditësit H. U. dhe atë Sh. H., R. U., Sh. H. dhe B. U. përmes përfaqësuesit të autorizuar av. Nexhat Beqiri, nga Vushtrria, duke e njoftuar gjykatën se paditësi ka ndërruar jete dhe kane kërkuar që të vazhdojë procedura me ta dhe të ju njihet legjitimiteti aktiv si pale paditëse në këtë procedurë.

Gjykata u ka njohur legjitimitetin dhe ka vazhduar me trashëgimtarët Sh. H., R. U., Sh. H.dhe B. U. si paditës ne këtë çështje kontestimore.

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit Sh. H., R. U., Sh. H.dhe B. U, përmes përfaqësuesit të autorizuar av. Nexhat Beqiri, nga Vushtrria, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, si ne kërkesëpadinë e precizuar me dt.21.05.2024, ashtu edhe gjate kësaj seance te datës se lartcekur pranë kësaj gjykate, ka kërkuar që te aprovohet kërkesëpadia dhe te detyrohet e paditura KEDS Sh.A, qe ne emër te shkaktimit te demit te vitit 2015 ne paluajtshmerite – pronat kadastrale me numër P-71208024-01016-0, Komuna Mitrovice, zona kadastrale Vidishiq lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private vendi i quajtur Sh. i A. ne sipërfaqe prej 66.58 dhe ne parcelën P-71208024-01017-0, Komuna Mitrovice, zona kadastrale V. lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private vendi i quajtur Sh. i A., ne sipërfaqe 50.382 m2 për prerjen e pyllit të ja kompensojë shumen prej 1960.61 euro, dhe atë me kamate ligjore prej 8% duke paguar prej momentit te paraqitjes se padisë e deri ne përmbushjen definitive, i kërkojë shpenzimet e procedurës ne shumen siç janë ne aktgjykimin e pare 594 euro si dhe për seancën e sotme 338.00 euro.

Përfaqësuesja e te paditurës KEDS Sh.A, - Dega Mitrovicë, gjate seancës gjyqësore dhe ne fjale përfundimtare ka deklaruar: e kundërshtojmë ne tërësi precizimin e kërkesë padisë se paditëseve dhe kjo për faktin se ne kohen kur është kryer prerja e drunjëve ne parcelat kontestuese ne muajin maj- korrik te vitit 2015 as atëherë paditësi H. U. e as trashëgimtarët ligjore nuk kane qene pronarë te ngastrave kontestuese pasi qe H. U. pronësinë e këtyre ngastrave e kishte fituar ne shtator te vitit 2015 e kjo vërtetohet edhe ne certifikatën e pronësisë e cila gjendet ne shkresat e lëndës, përveç kësaj e kundërshtojmë bazën e kërkesëpadisë për faktin se e paditura KEDS ka vepruar konform ligjit për Energjinë te vitit 2010 përkatësisht nenin 24 par.1, nenit 28 lidhur me mirëmbajtjen e rrjetit Energjetik dhe nenit 30 lidhur me zonat e sigurisë, përveç kësaj e kundërshtojmë edhe lartësinë e kërkesëpadisë për faktin se ekspertiza e pylltarisë gjate konstatimit për dëme nuk ka vepruar sipas Udhëzimit Administrativ qe aplikohet ne këtë gjendje faktike përkatësisht nuk ka vepruar sipas Udhëzimit Administrativ numër 2005/3 i Ministrisë se Energjisë dhe Minierave i datës 19.07.2015 i cili e ka rregulluar çështjen e kompensimit për çështjet e kësaj natyre përkatësisht neni 6 par.6, dhe nenit 7 te këtij Udhëzimi Administrativ dhe mbi te gjitha ka qene detyrim i paditësit dhe çdo personin fizik dhe juridik qe tu lejohet qasje e personave te autorizuar te ndërmarrjes te kenë qasje ne asetet e tyre për mirëmbajtje, kontrollim apo edhe prerje te drunjëve qe mund te paraqesin pengese për furnizim te rregullt me energji elektrike por edhe qe te shmange rrezikshmërinë për njerëzit dhe pronat për shkak te rrezikut potencial qe do te mund te shkaktonte mosmirëmbajtja e tyre. Nga provat e administruara u vërtetuan faktet se e paditura KEDS gjatë parcelave kontestuese ka pasur të shtrire rrjetin elektrik për shumë vite me radhë dhe përmes ligjit për energji të vitit 2010 përkatësisht nenit 24 par 1, ndërmarrjeve të energjisë ua njehtë drejtën e pronësisë servitutit dhe shfrytëzimit mbi parcelat ku janë të vendosura stabilimentet elektrike mbi pronat private edhe nëse më parë nuk u janë dhënë formalisht atëherë përmes veprimit të këtij ligji iu njihen këto të drejta. Mbi këtë bazë me qëllim të mirëmbajtjes të rrjetit elektrik dhe sigurimit me energji elektrike e paditura ndërmerr veprimet e saj për çdo vit duke bërë pastrimin e trasesë përgjatë linjave elektrike dhe këtë e ka rregulluar edhe neni 28 dhe 30 i ligjit për energji. Mbi këtë çështje e paditura nuk ka pasur asnjë

interes në shkaktimin e dëmit të paditësve por ka qenë qëllimi përmbushja e detyrimit ligjor të saj me qëllim që të mos rrezikohet njerëzit dhe pronat nga ky proces. Përveç kësaj llogaritja e lartësisë së kërkesëpadisë nga eksperti i pylltarisë nuk është bërë në përputhje me udhëzimin administrativ që i përgjigjet kësaj gjendje faktike siç është UA2005-3 i ministrisë së energjisë dhe minierave përkatësisht neni 6 par, 6 dhe neni 7 i saj. Përveç kësaj nga provat e administruar siç është certifikata e pronësisë shihet se paditësi në kohën kur janë kryer punimet nuk e ka pasur të drejtën e pronësisë me qëllim që për dëmet e pretenduara të kompensohet, ngase pronësinë e saj e ka fituar në shtator të vitit 2015. Pretendimet për prerjen e drunjëve se duhet të njoftohet paditësi apo pronari i tokës nga e paditura nuk është përcaktuar si detyrim ligjor me një dispozitë përkatëse por është detyrim i të paditurës që për çdo vit gjatë pastrimit të trasesë të njoftojë ministrinë e mbrojtjes së mjedisit dhe pylltarisë sa herë që fillon procesi i krasimit të traseve, dhe mbi të gjitha është detyrim i paditësit dhe çdo personi fizik apo juridik që personave të autorizuar të ndërmarrjes së energjisë t'iu lejohet qasja për kryerjen e punimeve, mirëmbajtjen, kontrollin apo edhe pastrimin përreth asetëve të energjisë siç përcaktohet me nenin 28 të ligjit për energji. Përveç kësaj çështja e trashëgimtarëve ligjor duke fituar legjitimitetin real në këtë çështje vlerësojmë se nuk është në përputhje me dispozitat e LPK dhe LTK, andaj mbi bazën e lartpërmendurave kundërshtojmë padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar si dhe shpenzimet e kërkuara nga përfaqësuesi i paditësve për shpenzimet e krijuara nga përfaqësuesi paraprak në këtë çështje kontestuese.

Andaj, duke ju referuar te lartpërmendurave, kërkojmë nga gjykata që padinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat si në vijim dhe ka lexuar: Procesverbali i përpiluar në vend të ngjarjes i datës 13.07.2015; Ekspertiza gjeodezike e datës 21.07.2017, me skicat e terrenit dhe kopjen e planit dhe shikimin në 34 fotografi me ngjyra të printuara në formatin A4 dhe të dorëzuara në CD; Përgjigja në kërkesën e datës 14.10.2015; Ekspertiza e Pylltarisë e datës 01.12.2015 dhe plotësimi i saj i datës 12.05.2016; Njoftimi i datës 21.07.2016 me numër protokolli 762/16; Njoftimi i Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit i datës 06.03.2015 me numër protokolli 198/15; dhe përgjigja në ekspertizë të paditurës dt. 27.06.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit **është e bazuar**.

3. Faktet

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata ka administruar ekspertizën gjeodezike të përpiluar nga eksperti N. M., e cila ekspertizë bazohet në dokumentacionin me të

cilin disponon dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, ne Mitrovicë. Gjykata vërteton faktin se parcela kadastrale P-71208024-01016-0, Komuna e Mitrovicës, zona kadastrale V. lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private, vendi i quajtur Sh.i A., ne sipërfaqe prej 0.66.58ha si dhe parcela P-71208024-01017-0, Komuna Mitrovice, zona kadastrale V., lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private vendi i quajtur Sh. i A., ne sipërfaqe 5.03.82ha, evidentohet ne emër te H. (R.) U.(prindi-babai i paditësve Sh. H., R.U., Sh. H. dhe B. U.). Nga ekspertiza e lartpërmendur gjykata ka vërtetuar dhe faktin se neper këto dy parcela kalon rrjeti elektrik i te paditurës.

Gjykata ne lidhje me lartësinë e kërkesëpadisë ka administruar ekspertizën e pylltarisë dhe plotësimin e saj te datës 01.12.2015 respektivisht 11.05.2016 te përpiluar nga eksperti i pylltarisë Emin Begu, ku ka ardhur ne përfundim se e paditura ne vendin e lartcekur pra ne pronën e paditësve, ka prere drunjë te llojit (ahu) dhe (lajthie), me vëllim te përgjithshëm prej 14.09 m3. Plotësimin e ekspertizës eksperti E. B. e ka përgatitur duke u bazuar nenin 8 par. 2 të udhëzimit administrativ MA-Nr. 12.2005, për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore – drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike, i nxjerre nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural te Republikës se Kosovës. Ku i njëjti ka përcaktuar ne ekspertize se vlere e drunjëve te prere ne parcelat e lartcekura ka qene 1960.61€.

4. Baza Ligjore

Në këtë çështje juridike kontestimore do të zbatohen dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve Nr.04/L-077(tani e tutje LMD), për shkak se demi i shkaktuar ka ndodhur ne vitin 2015 dhe ky ligj ka qene ne fuqi ne atë periudhe kohore. Bazuar në nenin 136 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimit (LMD) përcaktohet: *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në nenin 137 të po këtij ligji *“dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Neni 169 par.4 i LMD-se, përcakton *“Gjykata do t`i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”*

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se e paditura, gjate muajit maj te vitit 2015, ne fshatin V, Komuna e Mitrovicës, ka prere drunjte e llojit “Ah” dhe lajthi me qellim te krasimit te drunjëve dhe pastrimit te trasesë qe te funksionojë pa pengesa sistemi energjetik ne atë pjese.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se e paditura nuk e ka njoftuar pronarin e tokës ku janë prere drunjte. Këtë gjë nuk e ka kontestuar as e paditura e cila e ka njoftuar gjykatën me prova se

njoftimi nuk i është dërguar paditësit – pronarit te tokës pasi qe nuk kane pasur për obligim ta njofton.

Për gjykatën ka qene kontestuese se prona kontestuese ne te cilën janë prere drunjte nga ana e te paditurës, e kujt është dhe vlera e demit te cilën e kane kërkuar paditësit sa është.

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë kontestimore, e posaçërisht nga ekspertiza gjeodezike te përpiluar ne eksperti N.M. e cila ekspertize bazohet ne dokumentacionin me te cilin disponon dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, ne Mitrovicë. Gjykata vërteton faktin se parcela kadastrale P-71208024-01016-0, Komuna e Mitrovicës, zona kadastrale V. lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private, vendi i quajtur Sh. i A., ne sipërfaqe prej 0.66.58 ha si dhe parcela P-71208024-01017-0, Komuna Mitrovice, zona kadastrale V., lloji i njësisë parcele, tipi i pronës private vendi i quajtur Sh. i A, ne sipërfaqe 5.03.82 ha, evidentohet ne emër te H.(R.) U. (prindi-babai i paditësve Sh. H., R. U., Sh. H. dhe B. U.). Nga ekspertiza e lartpërmendur gjykata ka vërtetuar dhe faktin se neper këto dy parcela kalon rrjeti elektrik i te paditurës. Pra, parcelat kontestuese janë ne emër te prindit – babait te paditësve, te cilët paditës janë trashëgimtarët ligjor te tij pra te H. (R.) U.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur duke u bazuar ne ekspertizën e pylltarisë dhe plotësimin e saj te datës 01.12.2015 respektivisht 11.05.2016 te përpiluar nga eksperti i pylltarisë E. B., ku ka ardhur ne përfundim se e paditura ne vendin e lartcekur pra ne pronën e paditësve, ka prere drunjte e llojit (ahu) dhe (lajthie), me vëllim te përgjithshëm prej 14.09 m3. Plotësimin e ekspertizës eksperti E. B., e ka përgatitur duke u bazuar nenin 8 par. 2 të udhëzimit administrativ MA-Nr. 12.2005, për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore – drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike, i nxjerre nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural te Republikës se Kosovës. Ku i njëjti ka përcaktuar ne ekspertize se vlera e drunjëve te prere ne parcelat e lartcekura ka qene 1960.61€. Andaj, gjykata ekspertizës se tille i'a fali besimin ngase e njëjta ishte përpiluar mbi bazën e njohurive shkencore dhe profesionale pas daljes ne vendin e ngjarjes dhe ishte përpiluar ne pajtim dhe bazuar ne nenin 8 par. 2 të udhëzimit administrativ MA-Nr. 12.2005, për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore – drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike, i nxjerre nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural te Republikës se Kosovës.

Ne lidhje me pretendimet e te paditurës KEDS Sh.A, se e paditura përgjatë parcelave kontestuese ka pasur te shtrire rrjetin elektrik për shume vite me radhe dhe përmes ligjit për energji te vitit 2010 përkatësisht nenit 24 par.1, dhe nenit 30 ndërmarrjeve të energjisë ua njuh të drejtën e pronësisë - servitutit dhe shfrytëzimit mbi parcelat ku janë të vendosura stabilimentet elektrike mbi pronat private edhe nëse më parë nuk u janë dhënë formalisht atëherë përmes veprimit të këtij ligji iu njihen këto të drejta. Dhe ka te drejtën e paditura te pastrimit te trasesë. Mbi këtë çështje e paditura nuk ka pasur asnjë interes në shkaktimin e dëmit të paditësve por ka qenë qëllimi përmbushja e detyrimit ligjor të saj me qëllim që të mos rrezikohet njerëzit dhe pronat nga ky proces. E paditura ka kontestuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë duke pretenduar se ekspertiza e pylltarisë nuk është ne përputhje me udhëzimin administrativ që i përgjigjet kësaj

gjendje faktike siç është UA2005-3 i Ministrisë së Energjisë dhe Minerave përkatësisht neni 6 par, 6 dhe neni 7 i saj. Dhe si e paditur nuk kane pasur detyrim ligjor për njoftimin e paditësit apo pronarit te tokës për prerjen e drunjeve por e paditura ka për detyrim te njoftoje Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pylltarisë sa herë që fillon procesi i krasimit të traseve, dhe mbi të gjitha është detyrim i paditësit dhe çdo personi fizik apo juridik që personave të autorizuar të ndërmarrjes së energjisë t’iu lejohej qasja për kryerjen e punimeve, mirëmbajtjen, kontrollin apo edhe pastrimin përreth aseteve të energjisë siç përcaktohet me nenin 28 të ligjit për energji. Kjo gjykate nuk mund ti aprovoj këto pretendime si te arsyeshme dhe te bazuara. Për faktin se e paditura me asnjë prove te vetme nuk e ka dëshmuar se e ka njoftuar paditësin për ndërmarrjen e veprimit (prerjen e drunjeve). Kjo gjykate vlerëson se njoftimi është dashur t’i dërgohet paditësit, për prerjen e drunjeve ne pronën e tij ngase, ne nenin 18 par.1 te Ligjit Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore përcaktohet *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.”*, mbi bazën e kësaj dispozite, gjykata erdhi ne përfundim se veprimet e te paditurës për prerjen e pyllit kane qene ne kundërshtim me ligjin, pasi qe fillimisht është dashur te njoftohet paditësi per veprimet e te paditurës, mbi bazën e kësaj gjykata ka obliguar te paditurën ne kompensimin e demit sipas UA, MA-Nr. 12.2005, për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore – drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike, i nxjerre nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural te Republikës se Kosovës.

E paditura i’u ka referuar dispozitës se nenit 28 te ligjit për energji te vitit 2010 ku ne nenin 28 përcaktohet se : *“Personat fizikë dhe juridikë do të lejojnë zyrtarët që ushtrojnë inspektime në përputhshmëri me këtë ligj, mund të hyjnë dhe të kalojnë në pronën e çfarëdo individi për ushtrimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me inspektimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve energjetike, instalimeve apo sistemeve.”* Dhe nenit 30 përcakton *“Zonat e sigurisë duhet të vendosen përreth zonat energjetike.”* kjo gjykate vlerëson se ne rastin konkret se ish paditësi nuk është njoftuar asnjëherë ne lidhje me mirëmbajtjen apo trasimin e trasesë nga e paditura. Ndërsa neni 29 i po këtij ligji përcakton se *“Ndërmarrjet për energji i kompensojnë pronarët ose shfrytëzuesit e pronës për çfarëdo dëmi që mund të shkaktohet gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre që mund të rezultojë në kufizimin e shfrytëzimit të pronës ose zvogëlimit të vlerës së saj.”*, ne rastin konkret e paditura i ka shkaktuar dem paditësve duke bere prerjen e drunjeve ne sasinë e përcaktuar ne ekspertizën e pylltarisë, andaj edhe për këtë duhet kompensuar.

Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e morri konform nenit 452 parag.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TOA-së, ku e obligoi të paditurën e parë që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguaj shumën e përgjithshme prej 932.00€, në të cilat janë përfshirë përpilimi i padisë 104 €, për tri seanca te mbajtura 608, taksa gjyqësore 20 €, si dhe shpenzimet për dy ekspertiza 200 €.

Nga të dhënat e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetimin e këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2020:151468
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05760050

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
– Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1261/2020, datë 30.05.2024

Gjyqtari,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.